



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më .10.2023

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall**

*(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS - “Blerje kamera sigurie dhe Ndërtim i rrjetit LAN për Godinen e Bashkisë”**

**LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur – mallra”**

**CPV - 35125300-2 kamera sigurie, 32412000-4 rrjet i komunikimeve.**

**VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT- 13’186’292** (trembëdhjetëmilion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa tvsh.**

I mbajtur sot me date **13.10.2023**, ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Shtojca 7**

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.**

**Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertes, sipas shtojces 1;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Kriteri (1-a) është vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Kriteri (1- b) është vendosur në baze të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteri (1-c) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojcës 7

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te prokuruar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se përlogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik dhe fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

**ose**

b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e duhur per te permbushur me sukses kontraten.

## **2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese certifikaten e vlefshme:**

- SSH/EN ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” ose ekuivalente
- SSH/EN ISO/IEC 27001:2017 "Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit" ose ekuivalente

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

**Argumentim:** Kriteri 2.3.2 është vendosur bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 "Kërkesat e cilesise" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u nisur nga kërkesat e cilësisë së mallrave që do të furnizohen si dhe punimet komplekse që duhet të kryhen për të cilat duhet të jepet garanci. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Vendosija e ketyre certifikatave është kryer pas konsultimit dhe bazuar në Katalogun e Standarteve Shqiptare.

**ISO 9001:2015** - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë". ISO 9001:2008 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 9001: 2015 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se OE ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

**Certifikimi ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar ka standardet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës, pra është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara, si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria. Menaxhimi i sigurisë së informacionit që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet te disponoje Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës se artikujve:

- UPS 40KVA
- Switch 24 porta L2 i menaxhueshem
- Switch 24 porta L3 Menaxhueshem
- Switch 24 porta POE per wireless access point
- Switch 24 porta Gigabit POE
- Sistemi i monitorimit te kushteve mjedisore dhoma e serverave
- Wireless Controller
- Wireless Acces point
- PDU 16A
- Sistemi i akses kontrollit
- Video rregjistrator rrjeti me 64 kanale
- Kamera e brendshme inteligjente
- Kamera e jashtme me Ngjyra 24/7

Ne rastin e autorizimi te distributorit duhet paraqitur dhe marreveshja midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.3** është vendosur ne perputhje me nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Nenin 40 pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte vendosur qe operatori ekonomik qe do te ofertoje e garanton AK qe ka ose do te kete ne dispozicion mallin objekt prokurimi si dhe do ta furnizojë atë me mallra cilësorë dhe ne perputhje me specifikimet teknike.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit te prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave qe do te ofertohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga

prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar originalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës. Duke ju referuar frymës së legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrëjen e operatorëve ekonomik, autorizimi është kërkuar vetëm për pajisjet kryesore që kanë vlerë të konsiderueshme në preventiv

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fotografi/katalogë/ broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve për listën sipas pikes 2.3.3, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisjet që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit catalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Nr.	Emërtimi i mallrave	Modeli i pajisjes	Emri i prodhuesit	Titujt e katalogeve, nr. faqes së katalogëve për çdo pajisje të ofruar, etj.	Faqja zyrtare e internetit e prodhuesit
-----	---------------------	-------------------	-------------------	--	---

Kriteri **2.3.4** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika **6**, germa **b**) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur që AK të ketë siguri që operatori ekonomik që do të ofertoje do të jete në gjendje të realizojë kontratën me sukses dhe se produktet e ofruara do të jete në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë originalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Gjithashtu OE duhet të paraqesin fotografi/katalogë/broshurë për disa nga artikujt e objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë llojin e mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse mallrat që



do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specififikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për fotografi/katalogë/broshurë është vendosur (ato për të cilat është kërkuar autorizimi), që kanë vlerë të konsiderueshme.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë :

- Te paktën 1 (një) specialist i çertifikuar për CCNA ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) specialist i çertifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për serinë e UPS së ofertuar
- Te paktën 1 (një) specialist Certified Wireless Technician (CWT) ose ekuivalent.
- Të paktën 1 (një) specialist i çertifikuar për sistemet Access Control dhe CCTV

Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.5** bazohet në Nenin 40 pika 5, germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesat e mesipërme i shërbejnë AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka stafin e nevojshëm për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve të cilesive të kërkuar. Specialistet e kërkuar janë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen nga O.E në instalimin e pajisjeve, konfigurimin e tyre.

Kërkesat dhe specializimet e stafit që kërkohen janë të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës që prokurohet dhe realizimin e instalimeve brenda afatit, konfigurimet e pajisjeve të reja.

Specialisti i kërkuar me certifikimin CCNA ose ekuivalent është i domosdoshëm për të kryer punimet e rrjetit elektronik LAN ku përfshihen zërat e preventivit si: Instalime Elektrike dhe Network përfshirë materialet dhe Rack në dhomen e monitorimit, Punime Network dhe Elektrike për dhomen e serverit, instalimi dhe konfigurimi i switcheve etj, të cilat janë procese të një rëndësie të madhe për implementimin me sukses të projektit të parashikuar.

Po ashtu, specialisti i certifikuar CCNA ose ekuivalent do të realizojë identifikimin dhe riorganizimin e rrjetit, përfshirë pajisjet dhe linjat, spostimin dhe konfigurimin e tij në datacenter,

me qëllim rritje të efikasitetit të procesimit dhe komunikimit kompjuterik të cilat ndikojnë në procesin e punës së institucionit. Me qëllim zgjerimin e konkurrencës Autoriteti Kontraktor ka parashikuar edhe pranimin e një certifikimi ekuivalent.

Specialisti i kërkuar me certifikimin përserinë e UPS së ofertuar lidhet drejtpërdrejtë me kontratën objekt prokurimi, ku në preventivin e tij janë parashikuar furnizimi dhe vendosja e

UPS 40 kVA 3 faze in /1 out me bateri te brendeshme e cila kerkojn nje nderhyrje te specializuar dhe te dedikuar vetem per kete fushe.

Kjo pajisje ka nje vlere te konsiderueshme ne preventiv prandaj per AK, eshte e rendesishme te garantohet instalimi me sukses i saj nga specialist i certifikuar.

Me qellim zgjerimin e konkurrences Autoriteti Kontraktor ka parashikuar pranimin e certifikimeve jo vetem nga prodhuesi por edhe nga distributori i autorizuar.

Certifikimi i kerkuar per specialistin Certified Wireless Technician (CWT)ose ekuivalentvjen si nevojë e disa proceseve të punës, ku Operatori Ekonomik duhet të kryeje konfigurimin e 16 AP WIFI me kontrollerin WIFI. Ky process eshte mjaft delikat dhe kerkon nderhyrje te specializuar nga specialist te certifikuar,. Me qellim zgjerimin e konkurrences Autoriteti Kontraktor ka parashikuar edhe pranimin e nje certifikimi ekuivalent.

Specialisti i kerkuar me certifikiminper sistemet Access Control dhe CCTV lidhet drejtperdrejte me zerat e preventivit si: F.V Akses Kontrolli, NVR per kamerat e ambjenteve, kamera te pershtatshme per NVR, kamera per dhomen e serverit etj, instalimi dhe konfigurimi i te cilave kerkon nderhyrje nga specialist te certifikuar per kete qellim.

Kerkesat e mesiperme jane minimale dhe te domosdoshme per realizimin me sukses te kontrates objekt prokurimi, pasi në rastin konkret nuk ndodhemi para një kontrate klasike të furnizimit me mallra por janë parashikuar edhe procese të tjera si instalime dhe konfigurime te sistemeve te mesiperme sipas preventivit.

**2.3.6** Nje punësim mesatar **për tre muajt e fundit**, i të paktën **6** (gjashte) personave të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike , ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kriteri **2.3.6** bazohet ne Nenin 40 pika 5, gërmat b) dhe c) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe eshte vendosur duke pasur parasysh punimet qe do te kryhen per furnizimin dhe instalimin e pajisjeve, si dhe punonjesit e kualifikuar dhe ndihmes qe duhen per realizimin.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet te disponojë **1 (nje) automjet të përshtatshëm për transport mallrash** per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
- **ose**
- **Kontratën noteriale te marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga sasite e mallit është pare e nevojshme të kërkohej një automjet i pershtatshëm për transport mallrash.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**